

**AKTI I THEMELIMIT  
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“BLU BAY ITALIA SH.P.K**

Ne mbeshtetje te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 “Per tregetaret dhe shoqerite tregtare” i ndryshuar,te cilit ketej e tutje do i referohemi shkurtimisht si “**Ligji per shoqerite**”

Une **Domenico Carazita**, lindur më 28.04.1964 në Torino,dhe banues në Itali, me kartë identiteti Nr.AS2088436,me shtetesi dhe kombesi Italiane me zotësi te plotë juridike per te vepruar.Dhe une **Andrea Massimo Carazita**, lindur më 03.11.1972, në Torino, dhe banuese në Itali, me karte identiteti Nr.AY3392168, madhore, me zotësi te plotë juridike per te vepruar.Si dhe une **Melsen Marku,lindur** me.09.12.1984 ne Shqiperi, dhe benues ne Torino Itali,me zotesi te plete juridike per te vepruar.Sot me date.17.02.2020 , kemi hartuar Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqerise me perqejegjesi te kufizuar pa oferte publike si me poshte:

**THEMELUES/IT:**

Domenico Carazita, me atësi -GIUSEPPE, lindur më 28/04/1964 në TORINO dhe banues ne torino ne adresen: ITALI, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga Leternjoftim ID me Nr. as2088436 dhe Nr.Personal as2088436.

Andrea Massimo Carazita, me atësi -GIUSEPPE, lindur më 03.11.1972 në TORINO dhe banues ne torino ne adresen: ITALI, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga Leternjoftim ID me Nr. ay3392168

Melsen Marku , me atësi Maksim, lindur më 09.12.1984 në TORINO dhe banues ne torino ne adresen: ITALI, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga Leternjoftim ID me Nr. AY2225465.

Konform ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, shpreh vullnetin tim të lirë e të plotë, për të krijuar një shoqëri tregtare, të formës shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila do të krijohet dhe veprojë sipas legjisacionit në fuqi për shoqëritë tregtare.

Dispozitat e Aktit të Themelimit të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

**Neni 1**

**Emri i shoqërisë**

Emri i shoqërisë është "**BLU BAY ITALIA**" sh.p.k (*këtu e në vijim referuar si "shoqëria"*)

**Neni 2**

**Selia e shoqërisë**

1. Selia e shoqërisë është në adresën: Lagjja 28 Nentori, Rruga Hysni Alimerko, Objekti Nr. 20, Kati i Pare Vlore Veprimtaria e saj private ushtrohet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. Adresa e postës elektronike për komunikimin elektronik është blubayitalia@gmail.com
3. Ortaku i vetëm mund të vendos për transferimin e selisë së shoqërisë në një adresë tjeter, si dhe të vendos në lidhje me ndryshimin e të dhënave adresore apo mbylljen ose hapjen e degëve, zyrave të përfaqësimit, filialeve, brenda dhe jashtë vendit.

**Neni 3**

**Kohëzgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një kohëzgjatje të pacaktuar.

**Neni 4**

**Objekti i aktivitetit**

Ushtrim i aktivitetit Privat ne fushen e tregtimit te produkteve te naftes dhe nenprodukteve te saj. tregtimi i mallrave te ndryshem industrial dhe ushqimor, bujqesore dhe blegtorale, pije freskuese dhe alkolike, jo alkolike dhe import-eksport te ketyre mallrave, me shumice dhe pakice, import- eksport te artikujve dhe mallrave te ndryshme, etj..

- Ushtrim Aktiviteti PICERI-BAR-RESTORANT-HOTELERI

**2.2** Tregtimi i mallrave te ndryshem industrial dhe ushqimor, bujqesore dhe blegtorale, pije freskuese dhe alkolike, jo alkolike dhe import-eksport te ketyre mallrave, me shumice dhe pakice, import- eksport te artikujve dhe mallrave te ndryshme, import eksport tekstile, hapje dhe shfrytezim hotelesh, Bar-Kafe, Restorantesh Diskotekash, Qendrash Pushimi dhe Kurative, Qendrash Fitnesi, Hapje Linjash Interneti dhe venien ne sherbin te tij per te tretet.

2.3. Import eksport te hekurit

2.4. Te ofroj , kryej dhe drejoje sherbime Sipermarrje, projekte dhe veprimitari te te gjitha llojeve, ne lidhje dhe ne dobi te bashkepunimit , tregetise biznesit , telekomunikacioneve, mjedisit, menaxhimit, konsultimeve Investimeve, Agjensi Komisionere ne fushen e Perfaqësimit, Spedicionit, Ndermjetesimit, Marketingut.

**2.4.** Te krijoje, bleje, financoj, investoj, te hyje ne maredhenie te ndryshme me te tretet, te kryej sipermarrje dhe projekte te ofroj sherbime dhe asistence per riparimin dhe mirembajtjen te pajisjeve Audio,...etj , per persona Fizik dhe Juridik.

Asambleja e Pergjithshme ka të drejtë të përcaktojë modalitetet për zgjerimin apo zvogëlimin e fushës së aktivitetit të kryer. Shoqëria zbaton ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, për ushtrimin e veprimitarisë të saj.

**Neni 5**  
**Kapitali i shoqërisë**

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte :

100.000 LEK (Njeqind mijë leke)

**5.2.** Ortaket Themelues te Shoqerise: **Z. Domenico Carazita eshte** Zoterues i 1 (nje) kuote me vlore të per gjithshme 40 000 LEKE ( dyzet mijë ), që perben 40 % te Kapitalit Themeltar te Shoqerise, Andrea Massimo Carazita

Zoterues i 1 (nje) kuote me vlore te per gjithshme 40 000 LEKE ( dyzet mijë ), që perben 40 % te Kapitalit Themeltar dhe Melsen Marku Zoterues i 1 (nje) kuote me vlore te per gjithshme 20 000 LEKE (njezet mijë) që perben 20 % te Kapitalit Themeltar.

**Neni 6**  
**Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

1Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet në çdo moment me vendim të Asamblese se Pergjithshme në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*”, të ndryshuar.

2Në çdo rast kapitali i regjistruar nuk mund të zvogëlohet nën kufirin minimal të parashikuar nga ligji.

**Neni 7**  
**Asambleja e përgjithshme**

1. Organ vendimor në shoqëri është Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve që thirret në seancë të zakonshme të paktën dy herë në vit dhe drejtobet nga administratori i shoqërisë. Asambleja merr vendime të zakonshme dhe të jashtëzakonshme sipas dispozitiveve ligjore të përcaktuara në statut.
2. Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga te gjithe ortaket për sa kohë shoqëria ka vetëm një ortak. Kompetencat e administratorit përcaktohen në statut.
3. Vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilat nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
  - a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimitarisë; b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve; c) investime; ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
4. Çdo vendim i ortakut të vetëm që është i paregjistruar në regjistrin e vendimeve do të konsiderohet absolutisht i pavlefshëm.
5. Shoqëria nuk mund t'i kundër-drejtojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.
6. Nëse shoqërisë i shtohen ortakë të tjeter përvèç themeluesve atëherë asambleja e përgjithshme do të thirret, mblidhet dhe vendosë në përputhje me dispozitën ligjore të parashikuara në Ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 “*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*”, të ndryshuar.
7. Do të konsiderohen veprimitari të Shoqërisë vetëm ato veprime juridiko-civile që do të kryhen nga organet e saj konform disponimeve në Statutin e Shoqërisë dhe në mbështetje të legjislacionit në fuqi.
8. Shoqëria ka të drejtë të punësojë specialistë të fushës që i përket objektit të veprimitarisë si dhe punonjës të tjerë me kontratë pune sipas përcaktiveve në Kodin e Punës dhe përgjithësisht me legjislacionin shqiptar në fuqi.
9. Do të konsiderohen veprimitari të Shoqërisë vetëm ato veprime juridiko-civile që do të kryhen nga organet e saj konform disponimeve në Statutin e Shoqërisë dhe në mbështetje të legjislacionit në fuqi.

**Neni 8**  
**Administrimi i shoqërisë**

1. Kjo shoqëri ka statusin e personit juridik shqiptar dhe i nënshtrohet legjislacionit përkatës shqiptar.
2. Shoqëria do të administrohet nga administratori Andrea Massimo Carazita i zgjedhur nga ortaket për një periudhë maksimale prej 5 (pesë) vjetësh. Administratori mund të rizgjidhet ose shkarkohet nga ortaku i vetëm.
3. Me themelin e këtij akti, administrator i shoqërisë caktohet për një periudhë 5 (pesë vjeçare).
4. Në këtë shoqëri mund të aderojnë ortakë të tjerë të rinj në kushtet që do të përcaktohen në akt marrëveshjen e bërë në rastin e pranimit të tyre.
5. Po ashtu ortakët kanë të drejtën të ndryshojnë apo shtojnë objektin e veprimitarisë së shoqërisë, sipas interesave të veta ekonomike dhe financiare.
6. Administratori gëzon të drejta të plota në lidhje me administrimin e shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm. Ai mban përgjegjësi për veprimet e kryera gjatë administrimit të shoqërisë dhe mund të delegojë të tretë për të kryer veprime dhe akte të caktuara, në emër dhe për llogari të shoqërisë.
7. Administratori i vetëm vepron në respektim të politikave tregtare të përcaktuara nga asambleja e përgjithshme. Ai është përgjegjës për veprimet e kryera gjatë administrimit të shoqërisë, si dhe duhet të veprojë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të shoqërisë.
8. Shpërblimi i administratorit përcaktohet nga Asambleja e Pergjithshme

9. Çështjet e punësimit dhe marrëdhënies së punës së administratorit të vetëm rregullohet nga legjislacionin në fuqi për marrëdhëniet e punës, si dhe për sigurimet shoqërore e shëndetësore.

### **Neni 9 Kontrolli finansiar**

Kontrolli finansiar i shoqërisë kryhet nga auditues ligjor, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ortaku i vetëm do të emërojë një apo më shumë auditues ligjor në të gjitha ato raste kur emërimi vlerësohet i nevojshëm ose kërkon ligji.

### **Neni 10 Viti finansiar**

1. Viti finansiar i shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti, me përjashtim të vitit të parë të aktivitetit të shoqërisë, i cili fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë dhe mbylljet në fund të këtij viti.
2. Si rregull veprimet ekonomike të Shoqërisë mbyllen më 31 Dhjetor të çdo viti, përjashtim nga ky rregull do të bëhet kur kërkon organi kompetent ligjor.

### **Neni 11 Bilanci vjetor dhe dividendi**

1. Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, raportet e organit të administrimit dhe të audituesit ligjor (nëse është emëruar) miratohen nga ortaku i vetëm.
2. Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin finansiar miratohen nga ortaku i vetëm brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit finansiar.
3. Ortaku i vetëm vendos mbi shpërndarjen e dividentit në bazë të rezultatit finansiar të shoqërisë, sipas parashikimet të legjislacionit në fuqi.
4. Fitimi i nxjerrë nga aktiviteti i ligjshëm i kësaj shoqërie tregtare është në favor të ortakut të shoqërisë në masën 100% për ortakun .
5. Ndërkohë ortaku mbart mbi vete rrezikun e humbjes deri në masën 100% të kapitalit themeltar dhe atij rezervë.
6. Për dyerimet që shoqëria mund t'ju ketë personave të tjera juridikë apo fizikë përgjigjet me mjetet e veta financiare dhe materiale.
7. Për funksionimin normal të shoqërisë do të hartohet statuti i shoqërisë ku do të parashikohen hollësitë e mirëfunksionimit dhe administrimit të saj.

### **Neni 12 Prishja dhe likuidimi i shoqërisë**

1. Në rast të prishjes dhe likuidimit të shoqërisë, do të zbatohet dispozitat e Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqërítë tregtare”, të ndryshuar.
2. Kjo shoqëri mund të mbylli aktivitetin e vet në rastet e parashikuara në legjislacionin shqiptar dhe në statutin e saj.

### **Neni 13 Legjislacioni**

1. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me Aktin e Themelimit, Statutin dhe legjislacionin shqiptar në fuqi për shoqërítë tregtare.
2. Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakut të vetëm, administratorit dhe personave të tjera të punësuar në Shoqëri, në rast se nuk zgjidhen me pajtim, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.
3. Shoqëria do të marrë personalitet juridik me regjistrimin e saj në regjistrin tregtar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve.

Për sa më sipër, unë Ortaku i Vetëm themelues , hartova Aktin e Themelimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **“BLU BAY ITALIA” sh.p.k**, bazuar në vullnetin tim të lirë e të plotë, si dhe në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për shoqërítë tregtare. Pasi e hartova, e lexova dhe kuptova qartazi

rëndësinë dhe efektet ligjore të saj, unë ortaku i vetëm, e nënshkruaj Aktin e Themelimit të shoqërisë “**BLU BAY ITALIA**” sh.p.k. sipas ligjit.

**STATUTI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“BLU BAY ITALIA” SHPK**

Bazuar në ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, dhe të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë fushën e regjistrimit, licencimit dhe funksionimit të subjekteve tregtare në Republikën e Shqipërisë, në Vlore, sot, më datë 17 Shkurt 2020 ne Ortaket,

shpallim statutin e kësaj Shoqërie tregtare si më poshtë vijon:

**FORMIMI**

**Neni 1  
Emri i shoqërisë**

Formohet shoqëria tregtare me emërtimin “**BLU BAY ITALIA**” sh.p.k., (*këtu e në vijim referuar si “shoqëria”*), shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me tre ortak themelues.

**Neni 2  
Selia e shoqërisë**

1. Vendqëndrimi i shoqërisë tregtare “**BLU BAY ITALIA**” sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar do të jetë në: me Lagj 28 Nentori, Rruga Hysni Alimerko, Objekti 20, Katii Pare Vlore Veprimitaria e saj private ushtronhet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. Adresa e postës elektronike për komunikimin elektronik blubayitalia@gmail.com

3. Asambleja e Pergjithshme mund të vendos për transferimin e selisë së shoqërisë në një adresë tjetër, si dhe të vendos në lidhje me ndryshimin e të dhënave adresore dhe/ose mbylljen/hapjen e vendqëndrimeve të tjera, degëve, zyrave të përfaqësimit, filialeve, agjenci, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në çdo shtet tjetër të huaj, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me miratim të asamblesë së përgjithshme dhe në përputhje me ligjet e vendit apo shtetit përkatës ku ato do të hapen.
4. Shoqëria me vendimin e asamblesë së përgjithshme të saj, mund të investojë apo të marrë pjesë në kapitale të shoqërive të tjera me karakter tregtar apo investues, në shoqëri të tjera vendase apo të huaja, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
5. Shoqëria me vendimin e asamblesë së përgjithshme të saj, mund të kryejë operacione financiare duke u përfshirë në tregjet financiare apo tregjet e kapitaleve, të mbyllura apo të hapura, kombëtare apo ndërkombëtare.
6. Shoqëria me vendimin e asamblesë së përgjithshme të saj, mund të kryejë operacione financiare dhe transaksione financiare, me shoqëri të tjera brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të cilat janë në pronësi të ortakëve të saj, apo në të cilat ortakët e shoqërisë “**BLU BAY ITALIA**” sh.p.k në Shqipëri, mund të janë ortakë apo aksionerë edhe në këto shoqëri të tjera.
7. Shoqëria mund të shtojë numrin e ortakëve duke ndryshuar në këtë mënyrë numrin e ortakëve dhe pjesëmarrjen e tyre në kuotat e shoqërisë. Për këtë arsyе për të parashikuar mënyrën e funksionimit në rastet e shtimit të ortakëve në këtë statut janë përfshirë disa klauzola të përgjithshme që garantojnë funksionimin normal në periudha tranzitore. Në rast të shtimit të numrit të ortakëve dhe shndërrimit të shoqërisë nga shoqëri me një ortak në shoqëri me shumë ortakë, do të depozitoohen ndryshimet në QKR dhe do të specifikohen klauzolat e statutit, në përputhje me statutet e reja të krijuara.
8. Brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga shtimi i numrit të ortakëve, asambleja e ortakëve në mbledhje të jashtëzakonshme të saj do të vendosë për ndryshime eventuale të organeve, administratorit dhe statutit të shoqërisë.

### **Neni 3 Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimitarisë ekonomike të shoqërisë tregtare “**BLU BAY ITALIA**” sh.p.k. është e per një kohe te pacaktuar

### **OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

#### **Neni 4 Objekti i aktivitetit**

Ushtrim i aktivitetit Privat ne fushen e tregtimit te produkteve te naftes dhe nenprodukteve te saj. tregimi i mallrave te ndryshem industrial dhe ushqimor, bujqesore dhe blektorale, pije freskuese dhe alkolike, jo alkolike dhe import-eksport te ketyre mallrave, me shumice dhe pakice, import- eksport te artikujve dhe mallrave te ndryshme, etj..

-Ushtrimi i aktivitetit PIZERI-HOTELERI-BAR-RESTORANT

**2.2** Tregimi i mallrave te ndryshem industrial dhe ushqimor, bujqesore dhe blektorale, pije freskuese dhe alkolike, jo alkolike dhe import-eksport te ketyre mallrave, me shumice dhe pakice, import- eksport te artikujve dhe mallrave te ndryshme, import eksport tekstile, hapje dhe shfrytezim hotelesh, Bar-Kafe, Restorantesh Diskotekash, Qendrash Pushimi dhe Kurative, Qendrash Fitnesi, Hapje Linjash Interneti dhe venien ne sherbim te tij per te tretet.

2.3. Import eksport te hekurit

2.4. Te ofroj , kryej dhe drejoje sherbime Sipermarrje, projekte dhe veprimitari te te gjitha llojeve, ne lidhje dhe ne dobi te bashkepunimit , tregetise biznesit , telekomunikacioneve, mjedisit, menaxhimit, konsultimeve Investimeve, Agjensi Komisionere ne fushen e Perfaqesimit, Spedicionit, Ndermjetesimit, Marketingut.

**2.4.** Te krijoje, bleje, financoj, investoj, te hyje ne maredhenie te ndryshme me te tretet, te kryej sipermarrje dhe projekte te ofroj sherbime dhe asistencë per riparimin dhe mirembajtjen te pajisjeve Audio,...etj , per persona Fizik dhe Juridik.

Asambleja e Pergjithshme ka të drejtë të përcaktojë modalitetet për zgjerimin apo zvogëlimin e fushës së aktivitetit të kryer. Veç sa më sipër, në shoqëri do të zhvillohet çdo aktivitet tjetër që vetëm ose së bashku

me veprimtarinë kryesore të lartpërmendur, do të vlerësohen si të favorshme për zhvillimin, forcimin dhe rritjen e gjendjes ekonomike e financiare.

Shoqëria tregtare mund të ndryshojë emërtimin, vendqëndrimin dhe objektin e veprimitarisë së saj sipas vendimeve që do të marrë Asambleja e Përgjithshme.

Shoqëria zbaton ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, për ushtrimin e veprimitarisë të saj.

## KAPITALI I SHOQËRISË

### Neni 5 Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar filletar i shoqerise eshte :

100.000 LEK (Njeqind mijë leke)

**5.2. Ortaket Themelues te Shoqerise:** Z. **Domenico Carazita eshte** Zoterues i 1 (nje) kuote me vlore te përgjithshme 40 000 LEKE ( dyzet mijë ), qe perben 40 % te Kapitalit Themeltar te Shoqerise, **Andrea Massimo Carazita** Zoterues i 1 (nje) kuote me vlore te përgjithshme 40 000 LEKE ( dyzet mijë ), qe perben 40 % te Kapitalit Themeltar dhe **Melsen Marku** Zoterues i 1 (nje) kuote me vlore te përgjithshme 20 000 LEKE (njezet mijë ) qe perben 20 % te Kapitalit Themeltar.

### Neni 6 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

1. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet në çdo moment me vendim të organeve drejtuese të shoqërisë, në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.
2. Në çdo rast kapitali i regjistruar nuk mund të zvogëlohet nën kufirin minimal të parashikuar nga ligji.
3. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur detyrimin e tij në kapitalin themelor. Pjesët e kapitalit themelor janë lirisht të transferueshme prej trashëgimtarëve të çdo ortaku në rast vdekjeje.

## DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

### Neni 7 Asambleja e përgjithshme

1. Organi më i lartë i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme, ajo përbëhet prej ortakut të shoqërisë. Asambleja është organi sovran i shoqërisë duke u mbështetur në të drejtën e tyre të pronësisë private mbi mjetet e investuara në shoqëri.
2. Asambleja zhvillon mbledhje të zakonshme dhe të jashtëzakonshme. Ajo thirret jo më pak se dy herë në vit. Në mbledhje të jashtëzakonshme shqyrtohen dhe vendosen probleme që kanë të bëjnë me krijimin, bashkimin, ndarjen, shpërndarjen, ndryshimin e statutit e probleme të tjera të rëndësishme për të cilat kërkohet miratimi i përbashkët nga ortakët themelues.
3. Asambleja e Përgjithshme përcakton dhe miraton të drejtat dhe detyrat e organeve të saj. Të zgjedhurit dhe të emëruarit nga Asambleja veprojnë në përputhje me dispozitat e këtij statuti, aktit të themelimit si dhe ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Vendimet që merr Asambleja sipas këtij statuti dhe legjislacionit në fuqi janë të detyrueshme për çdo ortak. Secili ortak ka të drejtë vote sipas përqindjes në kuotën e kapitalit themelues të shoqërisë.
4. Secili ortak që ka të drejtën e pjesëmarjes së Asamble, mund të përfaqësohet në të edhe nga një person tjetër i autorizuar e shkrim nga ortaku i shoqërisë.
5. Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm, për sa kohë shoqëria ka vetëm një ortak.

6. Vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për: a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve; c) investime; ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
7. Çdo vendim i ortakeve që është i paregjistruar në regjistrin e vendimeve do të konsiderohet absolutisht i pavlefshëm.
8. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përvëç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.
9. Nëse shoqërisë i shtohen ortakë të tjeter përvëç themeluesit, që është në cilësinë e ortakut të vetëm, atëherë asambleja e përgjithshme do të thirret, mblidhet dhe vendosë në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

#### **Neni 8 Administrimi i shoqërisë**

1. Kjo shoqëri ka statusin e personit juridik shqiptar dhe i nënshtronhet legjisacionit përkatës shqiptar.
2. Shoqëria do të administrohet nga administratori **Andrea Massimo Carazita** i zgjedhur nga ortaket për një periudhë maksimale prej 5 (pesë) vjetësh. Administratori mund të rizgjidhet ose shkarkohet nga ortaku i vetëm.
3. Me themelimin e këtij akti, administrator i shoqërisë caktohet për një periudhë 5 (pesë vjeçare).
4. Në këtë shoqëri mund të aderojnë ortakë të tjera të rinj në kushtet që do të përcaktohen në akt marrëveshjen e bërrë në rastin e pranimit të tyre.
5. Po ashtu ortakët kanë të drejtën të ndryshojnë apo shtojnë objektin e veprimtarisë së shoqërisë, sipas interesave të veta ekonomike dhe financiare.
6. Administratori gëzon të drejta të plota në lidhje me administrimin e shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm. Ai mban përgjegjësi për veprimet e kryera gjatë administrimit të shoqërisë dhe mund të delegojë të tretë për të kryer veprime dhe akte të caktuara, në emër dhe për llogari të shoqërisë.
7. Administratori i vetëm vepron në respektim të politikave tregtare të përcaktuara nga asambleja e përgjithshme. Ai është përgjegjës për veprimet e kryera gjatë administrimit të shoqërisë, si dhe duhet të veprojë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të shoqërisë.
8. Shpërblimi i administratorit përcaktohet nga Asambleja e Pergjithshme
9. Çështjet e punësimit dhe marrëdhënies së punës së administratorit të vetëm rregullohet nga legjisacionin në fuqi për marrëdhëniet e punës, si dhe për sigurimet shoqërore e shëndetësore.

#### **Neni 9 Krijimi i shoqërisë**

1. Shoqëria tregtare “**BLU BAY ITALIA**” sh.p.k deklarohet se është krijuar dhe operon në zbatim të plotë të normave të legjisacionit shqiptar, të statutit, aktit të themelimit. Shoqëria fiton zotësinë për vepruar me regjistrimin e saj si person juridik në Regjistrin Tregtar të QKB-së (Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit).
2. Administrator i Shoqërisë do të përcaktohet me vendimin e asamblesë së përgjithshme të ortakëve. Afati i emërimit në dytë të administratorit është 5 vjet me të drejtë riemërimi.

#### **Neni 10 Vula e shoqërisë dhe llogaritë bankare**

1. Shoqëria ka vulën e saj, me mbishkrinin e emrit të shoqërisë “**BLU BAY ITALIA**” sh.p.k.
2. Ajo do te hape llogarinë e saj bankare në lekë e valuta të tjera në Bankat e nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

#### **Neni 11 Përgjegjësitë e shoqërisë**

- Shoqëria tregtare “BLU BAY ITALIA”, sh.p.k, vepron në regjimin e pronës private dhe merr përsipër vetëm të drejta dhe detyrime kontraktuale dhe jo kontraktuale brenda kapitalit të saj.
- Ortaku/ortakët e shoqërisë mbartin rezikun për rezultatet e veprimtarisë së shoqërisë në nivelin e kapitalit themelor të shoqërisë duke mos u përgjigjur me pasuritë vetjake të realizuara në veprimtari të tjera ekonomike për detyrimet e kësaj shoqërie.

**Neni 12**  
**Emërimi i organeve ose personave të tretë**

- Sipas nevojave që paraqiten për zhvillimin e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë, Asambleja emëron organe kontrolli si dhe punëson persona të tjerë të cilët qëndrojnë në detyrë deri sa të kërkohet nga Asambleja ose largohen me dëshirën e tyre.
- Administratorit me përjashtim të rastit kur është ortak i vetëm dhe administrator, nuk i lejohet të kontrakojë në çfarëdo forme qoftë të marrë hua në shoqëri të tjera, të japë pëlqimin në emër të shoqërisë për paradhënie e të bëhet dorëzanë apo të garantojë në emër të saj ndaj të tretëve.

**Neni 13**  
**Detyrat e Administratorit**

- Administratori merret me drejtimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë pa kufizime.
- Administratori ka për detyrë të njoftojë e të japë llogari në Asamblenë e Ortakëve me përjashtim të rastit kur është ortak i vetëm dhe administrator dhe si i tillë i mbart vetë këto cilësi.

**MARRËDHËNIET E PUNËS**

**Neni 14**

**Kontrata e Punës**

Marrëdhëni e punës në shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratës së punës duke zbatuar legjisacionin shqiptar. Shoqëria merr përsipër që të respektojë rregullat në fuqi të punësimit, ndërsa të punësuarit janë të detyruar të pranojnë ketë statut dhe çdo akt që rregullon veprimtarinë e shoqërisë.

**Neni 15**  
**Përgjegjësia e punonjësve**

- Të punësuarit në shoqëri përgjigjen sipas ligjit dhe sipas statutit. Për mos zbatimet dhe dëmet që mund t'i shkaktojnë shoqërisë mbajnë përgjegjësi administrative, disiplinore e penale.
- Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis të punësuarve dhe punëdhënësit kur nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, secula palë ka të drejtë që t'i drejtohet organeve të drejtësisë.

**Neni 16**  
**Marrëdhënia e të punësuarve me kapitalin e shoqërisë**

- Punonjësit e emëruar apo të punësuar nuk marrin pjesë në ndarjen e fitimit që realizon shoqëria në veprimtarinë e saj ekonomike, ndërsa kontrata e punës nuk është e parashikuar ndryshe.
- Të gjithë të punësuarit në shoqëri, janë të detyruar të ruajnë sekretin e punës në shoqëri. Kjo është e detyrueshme dhe pas largimit nga puna e tyre.

**PËRFAQESIMI I ADMINISTRATORIT**

**Neni 17**

**Caktimi i avokatit**

- Përfaqësimi i shoqërisë tregtare “BLU BAY ITALIA” SH.P.K., i takon Administratorit aktual të emëruar prej të saj. Ai ka të drejtë që të përfaqësojë shoqërinë në organet gjyqësore, bankare të caktøjë dhe emërojë avokatë ose përfaqësues të tjerë kur është e nevojshme.

**Neni 18**

## **Kontrolli finansiar**

1. Kontrolli finansiar i shoqërisë kryhet nga auditues ligjor, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Shoqëria organizon kontrollin e brendshëm me ekspert kontabël të emëruar me ose pa afat. Ortaku i vetëm emëron një apo më shumë auditues ligjor në të gjitha ato raste kur emërimi vlerësohet i nevojshëm ose kërkohet nga ligji.
2. Ekspertët kontabël kontrollojnë dhe garantojnë që llogaritë vjetore të janë të rregullta, të besueshme për rezultatin dhe gjendjen financiare. Ata kontrollojnë mbajtjen dhe evidentimin e veprimtarive financiare në përshtatje me ligjin dhe aktet e tjera për kontabilitetin. Ata janë përgjegjës ndaj shoqërisë dhe ndaj të tretëve për pasojat që rrjedhin nga fajet apo paaftësitet e tyre në kryerjen e detyrës.

### **Neni 10 Viti finansiar**

Viti finansiar i shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti, me përjashtim të vitit të parë të aktivitetit të shoqërisë, i cili fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë dhe mbylljet në fund të këtij viti.

### **BILANCI DHE TË ARDHURAT Neni 22**

#### **Viti finansiar**

1. Viti finansiar i shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti, me përjashtim të vitit të parë të aktivitetit të shoqërisë, i cili fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë dhe mbylljet në fund të këtij viti.
2. Si rregull veprimet ekonomike të Shoqërisë mbyllen më 31 Dhjetor të çdo viti, përjashtim nga ky rregull do të bëhet kur kërkon organi kompetent ligjor.
  1. Veprimtaritë ekonomike dhe financiare të shoqërisë mbyllen më datë 31 Dhjetor të çdo viti. Administratori i shoqërisë nxjerr bilancin kontabël dhe raportin përkatës në përputhje me dispozitën ligjore dhe kontabilitetin.
  2. Raporti i administrimit, inventaret, bilancet dhe llogaritë vjetore të hartuara i nënshtrohen pa përjashtim miratimit nga Asambleja e ortakëve (ortaku i vetëm) brenda afateve të caktuara.
  3. Me miratimin e bilancit kontabël shoqëria vendos përfondet e nevojshme për zhvillimin, si p.sh fondi rezervë, akte të akumulimit, investimit, etj.

### **Neni 23 Bilanci vjetor dhe dividendi**

1. Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, raportet e organit të administrimit dhe të audituesit ligjor (nëse është emëruar) miratohen nga Asambleja e Pergjithshme
2. Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin finansiar miratohen nga Asambleja e Pergjithshme vetëm brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit finanziar.
3. Asambleja e Pergjithshme vendos mbi shpërndarjen e dividentit në bazë të rezultatit financiar të shoqërisë, sipas parashikimet të legjislacionit në fuqi.
4. Të ardhurat neto pas vecimit të fondevë si më sipër dhe shlyerjes së detyrimeve fiskale i mbesin përfedorim ortakëve të shoqërisë të cilët i ndajnë midis tyre në përputhje me kuotat e secilit në formimin e kapitalit themelor të shoqërisë përcaktuar sipas parashikimeve të aktit të themelimit.
5. Çdo ortak ka të drejtën e transferimit jashtë vendit të pjesës së fitimit duke zbatuar dispozitat ligjore për këtë.
6. Asambleja e ortakëve mund të vendosë që të shpërndahen shumat e fondevë të rezervuara duke treguar shprehimisht llojin e rezervës ku janë marrë.

## Neni 24

### Ruajtja e dokumentacionit

Në selinë e shoqërisë tregtare mbahet dokumentacioni i plotë i saj, mbahen protokollet e ndryshme, dokumentacioni i kontabilitetit ku mund të bëhet vetëkontroll ose për t'ia vënë në dispozicion çdo organi kontrolli ta ngarkuar me ligj. Dokumentet e shoqërisë duhet të njohen mirë nga ortakët.

## SHPËRBËRJA E SHOQËRISË

### Neni 12

#### Prishja dhe likuidimi i shoqërisë

1. Shpërbërja e shoqërisë mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkaku si në rastin e falimentimit, privimi i të drejtës për të ushtruar profesionin e tregtarit, forca madhore, raste lufte dhe çdo formë tjeter që nuk varet nga dëshira e Asamblesë së ortakëve. Në rast të prishjes dhe likuidimit të shoqërisë, do të zbatohet dispozitat e Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.
2. Në çdo rast Asambleja vendos mbi mënyrën e likuidimit të shoqërisë duke caktuar një ose më shumë likuidatorë.
3. Likuidatorët dhe administratorët janë përgjegjës për ruajtjen e pasurisë së shoqërisë derisa t'u dorëzohet personave përkatës fizik e juridikë duke i dhënë përparësi likuidimit të detyrimit të shoqërisë ndaj të tretëve.
4. Mbas likuidimit të tij gjithë detyrimeve ndaj të tjerëve likuiduesi i ndan kapitalet e mbeturë mes ortakut/ortave përpjesëtimisht me kuotat që ata zotërojnë në kapitalin themelor.
5. Mbasi bëhet njoftimi i mbylljes së likuidimit dhe kryhen formalitet e mbylljes Shoqëria q'registrohet nga regjistri i tregtarëve të QKB-së (Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit).

## DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 26

#### Legislacioni i zbatueshëm

1. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me Aktin e Themelimit, Statutin dhe legjislacionin shqiptar në fuqi për shoqëritë tregtare.
2. Për sa nuk është shprehur në këtë statut i referohet plotësimi me Asambleja e Përgjithshme duke i mbajtur parasysh kërkeshat e ligjit 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis palëve nëse nuk gjejnë zgjidhje me bisedime e mirëkuptim, do të zgjidhen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor përkatës (*Kompetenca Territoriale*).
4. Çdo ndryshim e plotësim në statut nuk prek personalitetin juridik të shoqërisë tregtare **“BLU BAY ITALIA” sh.p.k.**

Për sa më sipër, unthemeluesit hartuan STATUTIN e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **“BLU BAY ITALIA” sh.p.k.**, bazuar në vullnetin tim të lirë e të plotë, si dhe në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare.

Pasi e hartova, e lexova dhe kuptova qartazi rëndësinë dhe efektet ligjore të saj, ne ortaket themelues e nënshkruajme Aktin e Themelimit të shoqërisë **“BLU BAY ITALIA” sh.p.k.** sipas ligjit.

## ORTAKET THEMELUES I STATUTIT TË SHOQËRISË MË PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"BLU BAY ITALIA" SH.P.K.

1. Domenico Carazita 2. Adrea Massimo Carazita 3. Melsen Marku

CARAZITA Domenico CARAZITA ANDREA Melsen Marku

